



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI PER ÇESHTJET LIGJORE

RAPORT VENDIMARRJE

Nr. 2, Datë 28.08/2025

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt-vendimit nr.....datë,/...../2025 "Mbi miratimin e Planit Vendor te Integritetit 2025-2028, Bashkia Elbasan"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Elbasan

Hyrje

Ky projekt-vendim paraqitet nga Drejtoria e Monitorimit, Sektori i Statistikave dhe Performances, dhe ka për qëllim:

BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI	Plani mbështetet në: VKM nr. 241, datë 18.04.2018, "Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Integritetin në Sektorin Publik" dhe aktet nënligjore në zbatim; Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion 2024–2030; Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Kuadrin për menaxhimin e riskut institucional, etikën dhe konfliktin e interesit (ILDKPKI; VKM nr. 873, datë 24.11.2021 për rregullat e etikës në administratën publike); Parimet e OGP Local për qeverisje të hapur, pjesëmarrje qytetare dhe transparencë.
SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT	Qëllimi: Konsolidimi i sistemeve të parandalimit të korrupsionit dhe forcimi i etikës institucionale përmes mekanizmave të matshëm, digjitalë dhe pjesëmarrës. Objektivat strategjikë (2025–2028): OS-1: Konsolidimi i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Riskut të Integritetit (SIMRI) Hartimi/azhurnimi i hartës së riskut; kontrolle parandalimi; audit i brendshëm tematik. OS-2: Transparencë & Llogaridhënie Rritja e publikimeve proaktive; buxheti i hapur; gjurmueshmëria e vendimmarrjes; të dhëna të hapura. OS-3: Zhvillim i Burimeve Njerëzore Kodi i sjelljes; trajnime periodike për etikë/konflikt interesi/sinjalizim; vlerësim performance lidhur me integritetin. OS-4: Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare oKonsulta të rregullta, platforma digjitale për sugjerime/ankesa/sinjalizime, forume komunitare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI PER ÇESHTJET LIGJORE

SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet)	<i>Te gjitha kostot e planit do te llogariten ne muajt ne vazhdim dhe do te pasqyrohen ne pogramin buxhetor afat-mesem (PBA) 2026-2028. Financimi i planit do të mbështetet në burime të kombinuara nga buxheti vendor, dhe nga bashkëpunimi me partnerë zhvillimi, organizata dhe donatorë. Nuk krijohen detyrime të reja të pambuluara buxhetore; çdo masë shoqërohet me preventiv dhe burim financimi.</i>
DREJTORIA PËRGJEGJËSE	<i>Drejtoria e Monitorimit, Sektori i Statistikave dhe Performances</i>
RAPORTIMI DHE MONITORIMI	<i>Monitorim tremujor nga Drejtoria e Monitorimit & Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Raportim vjetor te Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak; publikim në faqen zyrtare; Rishikim i mes-mandatit (2027) dhe rishikim final (2028).</i>
IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN	<i>Ulje e riskut të shkeljeve etike dhe korrupsionit. Rritje e besimit publik dhe cilësisë së shërbimeve. Standardizim i proceseve dhe gjurmueshmëri më e lartë. Rritje e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare.</i>
KONSULTIMI PUBLIK	<i>Ky projekt vendim kërkon konsultim publik sipas nenit 17 te ligjit 139/2015, të Rregullores së Këshillit. Eshte marre vendimi i Kryesise per kalimin ne konsultim publik te projektaktit. Eshte hartuar dhe publikuar ne faqen e internetit te Bashkise Elbasan, njoftimi dhe kalendari per degjasat publike. Eshte realizuar nje degjese me publikun date 25/08/2025, ku kane marre pjese 23 persona. Eshte mbajtur procesverbali i takimit dhe kane dale rekomandimet per konsultimin publik te cilat jane permbledhur dhe i jane derguar Kryetarit te Bashkise per reflektim.</i>

Komisioni i Përhershëm i Arsimit, i mbledhur më datën/...../2025 pasi shqyrtoi Projekt-vendimin për miratimin e Projekt Aktit, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI PER ÇESHTJET LIGJORE

1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.
 - b. Miratimin e projektaktit
 - c. Refuzimin e miratimit të Projektaktit
 - d. Ti kerkoje drejtorise perkatese informacion shtese per projektvendimin
 - e. Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
 - Pika e projektvendimit të ndryshojë në “ _____ ”
 - Pika e projektvendimit të ndryshojë në “ _____ ”
 - Tabela e projektvendimit të ndryshojë në “ _____ ”
 - Paragrafi i projektvendimit të ndryshojë në “ _____ ”

Bashkëlidhur argumentat e Vendimarrjes dhe mendimi i pakicës i parqitur në procesverbalin e Komisionit

Kryetari i Komisionit:	Luiza Popja
Nenkryetar i Komisionit:	Andi Shtylla
Sekretare e Komisionit:	Majlinda Kaçuli
Anetar i Komisionit:	Arber Fetah
Anetar i Komisionit:	Eva Bica
Anetar i Komisionit:	Erion Murataj
Anetar i Komisionit:	

Elbasan, më: 29.08/2025